



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1398/1 Prot.

Durrës, më 11.09.2023

VENDIM

Nr. 51, datë 11.09.2023

"Për miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm, për periudhën 2024-2026, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës "

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", zbatim të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Rregullores Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit nr. 22, datë 07.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesë 2024-2026" Shkresës prot.nr., 4501/1 datë 18.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2024-2026", të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Shkresës prot.nr., 4501/1 datë 18.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2024-2026", të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Shkresës nr. 1000/1, datë 22.06.2023 të Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor, Shkresës nr. 1000/2, datë 14.07.2023 të Fakultetit të Biznesit, Shkresës nr. 1000/3, datë 14.07.2023 të Fakultetit të Edukimit, relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 11.09.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm, për periudhën 2024-2026, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelave të Aneksit 7 A, bashkëngjitur .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI